

Dokumentacioni për Marrëveshjen e Lidhjes:

Për të nënshkruar ‘Marrëveshjen e Lidhjes’ me Rrjetin e Transmetimit, pasi është marrë më parë *Miratimi paraprak i lidhjes*, duhet të dorëzohet pranë OST sh.a. dokumentacioni i mëposhtëm:

- Plan-vendosje në hartë e linjës elektrike, traseja dhe planimetria e saj në formate të vizatimit A3;
- Skema principale e Centralit, Nënstacionit ngritës dhe lidhjes me rrjetin e transmetimit (Single Line Diagram);
- Skema principale të mbrojtjes rele dhe matjes (pjesa TL përfshirë transformatorin e fuqisë TL/TM kV);
- Diagrama e mbrojtjes rele;
- Diagrama e telekomunikacionit;
- Diagrama e kontroll-monitorimit;
- Specifikime teknike të pajisjeve kryesore (pjesa TL dhe transformatorin e fuqisë TL/TM kV);
- Formularin A2 me të dhëna për TEC/HEC/WEC/PVEC;
- Formularin B me të dhëna për linjën e transmetimit;
- Formularin C me të dhëna për Nënstacionin ngritës TL/TM;
- Planimetrinë e N/Stacionit ngritës TL/TM;
- Harta me Plan-vendosjen e nënstacionit dhe pika e lidhjes në rrjetin e transmetimit;
- Deklarata e Gadishmërisë për respektimin e kërkesave të Kodit të Rrjetit të Transmetimit;
- Deklarata mbi Përgjegjësitë për kontrollin dhe mirëmbajtjen e paisjeve, për operimin e paisjeve dhe përgjegjësitë për sigurimin teknik të personelit;
- Dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifave të lidhjes të re.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Lidhjes, investitori fillon punën për realizimin e projektit të zbatimit, ku pjesa që i përket Nënstacionit ngritës, linjës së transmetimit dhe pikës së lidhjes në rrjetin e transmetimit, duhet të dërgohen për aprovim në kompaninë OST sh.a. përpara fillimit të implementimit për të marrë aprovimin teknik.